



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1441/1 prot.

Tiranë, më 26.5.2025

VENDIM

Nr. 11, datë 26.5.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria _____, përfaqësuar nga administratori _____ (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1441 Prot., datë 22.05.2025, me objekt “*Ankim për cënimin e së drejtës së informimit*”, kundër Zyrës së Noterisë së znj. Gentjana Brati.

Ankuesi, me anë të shkresës datë 09.04.2025, ka kërkuar nga zyra e sipërcituar, t’i vendoset në dispozicion informacioni *nësë është çelur trashëgimia ligjore e të ndjerit z. _____, si dhe nëse rezulton të jetë çelur një kopje e thjeshtë e saj.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Zyra e Noterisë së znj. Gentjana Brati nuk ka kthyer përgjigje për sa është kërkuar, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që*

ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”, ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, Zyrës së Noterisë së znj. Gentjana Brati.

Nga verifikimi i kryer, rezulton se zyrat e noterisë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe atë të znj. Gentjana Brati, funksionojnë në përputhje me ligjin nr.110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, i cili përcakton rregullat për ushtrimin e profesionit të noterit, si dhe mënyrën e organizimit/funksionimit të shërbimit të noterisë. Ky ligj ka si qëllim garantimin e shërbimit të noterisë dhe ushtrimit të profesionit të noterit në mënyrë të pavarur dhe në mbështetje të ligjit.

Neni 4 i ligjit të sipërcituar, parashikon se: *“Profesioni i noterit në Republikën e Shqipërisë është një funksion i pavarur, me karakter publik, në shërbim të personave fizikë dhe juridikë, i cili ushtrohet nëpërmjet hartimit të akteve juridike dhe ushtrimit të veprimtarive noteriale të tjera, të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.”*

Për sa më sipër, Komisioneri thekson se, objekti i LDI, është garantimi i njohjes së publikut me *informacion/dokumentacion publik*, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në pikën 2, të nenit 2, të LDI parashikohet se: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Ndërkohë, në kuptim të nenit 2, pika 1 e LDI, *“Autoritet publik”*: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative’, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Bazuar në parashikimet e sipërcituara rezulton se, Zyra e Noterisë së znj. Gentjana Brati nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1441 Prot., 22.05.2025, të Shoqërisë , përfaqësuar nga administratori, z. , kundër Zyrës së Noterisë së znj.Gentjana Brati, me objekt “Ankim për cënimin e së drejtës së informimit”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 26.5.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi